

P 734/11
8 qershor 2011

GJYKATA KOMUNALE PRIZREN

Gjyqtari i EULEX-it Witold Jakimko si kryetar i trupit gjykues,

I ndihmuar nga:

Sonila MacNeil, si proces-mbajtës

Në lëndën penale kundër:

Zahide Gjonaj, emri i babait Nue Shabani, emri i nënës Palin Rama, lindur më 15 maj 1959 në Stublla e Eperme në Komunën e Vitisë, tani banuese në Rruga UCK, blloku 1, hyrja 1, nr 1710 Gjakovë, shqiptare e Kosovës, e martuar, nënë e pesë fëmijëve, avokate, gjendja ekonomike e varfër, dhe

akuzuar

sipas Propozim-akuzës PPS. Nr. 33/2010, të ushtruar nga Prokurori Special i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës datë 24 mars 2011, me të cilën Zahide Gjonaj akuzohet për veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, nga Neni 339 (1) i Kodi Penal i Kosovës dhe të dhënies së kundërligjshme të ndihmës ligjore, nga Neni 336 (1) i Kodit Penal të Kosovës,

siç përshkruhet më poshtë:

Zahide Gjonaj, gjatë punës së saj si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2010, ka shpërdoruar pozitën zyrtare të saj dhe ka vepruar në tejkalim të kompetencave të saj duke vendosur me aktgjykim përfundimtar lëndë që nuk i kishte marrë në mënyrën e duhur për gjykim, dhe në tejkalim të kompetencave të saj duke marrë dhe gjykuar lëndë që nuk përfshiheshin në juridiksionin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Për më tepër, ajo u dha ndihmë ligjore të kundërligjshme palëve duke shkruar për ta propozimet për shkurorëzim me marrëveshje në zyrën e saj në lëndë të cilat ajo i gjykoi dhe vendosi më pas.



Me çka ajo ka kryer veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtare, nga Neni 339 (1) i Kodit Penal të Kosovës dhe të dhënies së kundërligjshme të ndihmës ligjore, nga Neni 336 (1) i Kodit Penal të Kosovës.

pas mbajtjes së seancës paraçprake

më 8 qershor 2011 në prani të të pandehurës, mbrojtësit të saj dhe Prokurorit,

nxjerr këtë:

AKTVENDIM

Në bazë të Nenit 468 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) lidhur me Nenin 316 (1) nën-paragrafi 4 të KPPK-së, Propozim-akuza me akuzat kundër Zahide Gjonajt, siç u përshkrua më lart, **HIDHET POSHTË.**

ARSYETIM


Më 18 prill 2011, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ushtroi propozim-akuzë kundër Gjonajt për veprat e cekura më lart.

Në bazë të dispozitave të cituara në diapozitiv, kryetari i trupit gjykues vendosi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se Gjonaj i ka kryer veprat penale të përshkruara në propozim-akuzë.

Në veçanti, duhet theksuar se Prokurori nuk i paraqiti gjykatës ndonjë provë që të vërtetonte:

- 1/ përfitim të paligjshëm ose përfitim personal të siguruar nga ana e të pandehurës kur pretendohet se ajo ka shpërdoruar pozitën ose autorizimin e saj,
- 2/ dëmtim të shkaktuar palëve në procedurë, kur e pandehura veprroi si kryetare e trupit gjykues,
- 3/ qëllimin konkret lidhur me të dyja rrethanat e mësipërme,
- 4/ dhënien e ndihmës ligjore kundrejt shpërblimit (në veçanti, me theks në elementin e fundit);

Për sa u takon të katër pikave të renditura më lart, gjykata u pengua nga mungesa e një prove të vetme të qartë për të mbështetur dyshimin e bazuar se e pandehura i ka kryer veprat penale me të cilat akuzohet. Për më tepër, disa prova të paraqitura nga Prokurori flisnin për të kundërtën.



Gjatë seancës paraprake, Prokurori nuk arriti ta plotësonte akuzën e tij në mënyrë të kënaqshme.

Gjatë seancës së mbajtur më 8 qershor 2011 dhe pasi dëgjoi palët, kryetari i trupit gjykues urdhëroi ndarjen e procedurës për të pandehurën tjetër, Myrvete Berisha, dhe vendosi që procedura kundër Gjonajt të vazhdohet nën një numër tjetër reference.


Ky aktvendim dhe shpjegimi i shkurtër i tij përmbush plotësisht kërkesën e parashikuar nga Neni 468 (2) i KPPK-së.

Ky Aktvendim i dorëzohet prokurorit, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj.

GJYKATA KOMUNALE PRIZREN
Nr. 734/11, datë: 08.06.2011

Kryetar i trupit gjykues
Witold Jakimko

Proces-mbajtëse
Sonila MacNeil



SHARTËSINE E KOPJES E VËRTETON
ТАЧНОСТ КОПИЈА ПОТВРЂУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Dyfishin radnik

MJET LIGJOR:

Aktvendimi i gjyqtarit për të rrëzuar akuzën mund të ankimohet nga Prokurori tek kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës Komunale Prizren brenda tre ditëve nga dorëzimi i aktvendimit tek Prokurori.